

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“AVA 2” shpk**

Sot me date 08.11.2022, ne te nenshkruarit:

1. Artur Veshti , atesia Pal , i datelindjes 01,04,1974 , lindur ne Lezhe dhe banues ne Lezhe, rrethi Lezhe, mbajtes i kartes se identitetit me nr. H40401126E

me vullnetin e lire e te plote perpilojme kete akt themelimi:

NENI 1

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emeruar :

“AVA 2” shpk.

NENI 2

Shoqeria deklarohet e krijuar nen ruajtjen e plote te normave qe permban ky akt.

NENI 3

Veprimtaria e shoqerise, marredheniet e saj me persona te trete juridik, vendas e te huaj, shteteror e privat, rregullohen ne baze te ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” nr.9901 date 14.04.2008 si dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketij ligji.

Shoqeria pergjigjet vetem per pasurine e saj.



NENI 4

Selia e shoqerise do te jete:

Qarku Lezhe,Rrethi Lezhe, Lagjja Beslidhja, Rruga Shtraus,pasuria Nr 4/181+1-N10 Kati I.

NENI 5

Veprimtaria e shoqerise, emertimi e selia e saj, te percaktuara ne kete akt themelimi, nuk mund te ndryshojne pa pelqimin e themeluesve te saj.

NENI 6

Objekti i vepritarise se shoqerise do te jete :

Import, eksport, shitje, blerje, Punime te ndryshme ndertimi,civile,suva,punime mermeri,gure artistike,punime trotuare rruges, mirmbajtje dhe pastrim plazhi,lyerje godinash, mirmbajtje rruges, tregtim materiale te ndryshme, transport per nevoja te veta dhe per te trete.

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 3,000.000 lek

Kontributi i ortakeve themelues eshte :

1. Artur Veshti ka 100 % te aksioneve , me kuote te barabarte me 3 000 000 lek , 1 Kuote

NENI 8

Per nevoja te punes dhe te ushtrimit te aktivitetit te saj shoqeria mund te çeli llogari ne cdo banke te njohur me ligj qofte private apo shteterore.

NENI 9

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat. Por shoqeria mund te ndryshoje kete afat me vendim te themeluesve te saj
Gjithashtu shoqeria mund te shperbehet edhe perpara ketij afati per rastet e parashikuara ne ligj



NENI 10

Ortakët e shoqërisë “AVA 2” shpk janë:

1. Artur Veshti

NENI 11

Administratori i shoqërisë është Z. **Artur Veshti**, për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërsëritje

Administratori mban përgjegjësi vetëm për ruajtjen e karakterit të fshehtësisë së aktivitetit dhe të dokumentacionit të shoqërisë.

NENI 12

Organet e shoqërisë janë :

1. Asambleja e Ortakëve e përbërë nga ortakët e shoqërisë.
2. Komisioni I ekspertëve kontabel. Modalitetet e formimit dhe të funksionimit të tyre përcaktohen në statutin bashkëngjitur.

NENI 13

Për nevojat e punës kjo shoqëri mund të përdorë edhe punëtorë e specialistë të ndryshëm, me kontrata të rregullta pune sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 14

Dispozita me të hollësisht për shoqërinë përcaktohen në statutin bashkëngjitur.

NENI 15

Ky statut u reduktua në tre kopje, njëra në Qendren Kombëtare të Biznesit, një në Degen e Tatimit Taksave dhe një kopje mbahet në dokumentacionin e shoqërisë.

ORTAKET THEMELUES
Artur Veshti

